



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI QARKUT SHKODËR

KRYETARI

Nr. 393/1 Prot.

Shkodër, më 11/07/2024

VENDIM

Nr. 11, Datë 09.07.2024

### “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027, PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 09.07.2024, pasi dëgjoji materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër “Për miratimin e Projektit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Këshillin e Qarkut Shkodër”, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nënin 36,37 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit Nr.3, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”, shkresën nr 8592, datë 1906.2024 “Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027, pasi u diskutua në mbledhjen e kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër dt.28.06.2024, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u *miratua* me *13 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim*,

#### VENDOSI;

1. Të miratojë Projektin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, për Këshillin e Qarkut Shkodër sipas relacionit bashkangjitur shpjegues për procesin e përgatitjes së PBA-së (sipas shtojcës 2, PBA 2025-2027) si dhe pasqyrat të gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor(SMBV) si më poshtë;
  - a. Raporti i PBA1-Tavanet e PBA sipas Programeve
  - b. Raporti i PBA2-Parashikimi i të Ardhurave
  - c. Raporti i PBA3-Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik.
  - d. Raporti i PBA4-Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit funksional.
  - e. Raporti i PBA5-Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit ekonomik.
  - f. Raporti i PBA6-Deklarata e Politikës së Programit.
  - g. Raporti i PBA7-Shpenzimet e produkteve të Programit.

- h. Raporti i PBA8-Projektet e investimeve.
  - i. Raporti i PBA9-Information me të dhënat e programeve
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
  3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

